



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ALBANA XH. SPAHIU
ADRESA NR.9, HAXHI HYSEN
DALLIU, NR.59, NR.11
TEL: 672530602

VENDIM PËR LËSHIMIN E DËSHMISE SË TRASHËGIMISË LIGJORE

Nr. repertori: 2325

Nr. koleksioni: 908

Tirane më 12/07/2024

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2024051000092762368



A2024051000092762368



V E N D I M

PËR LËSHIMIN E DËSHMISË SË TRASHËGIMISË LIGJORE

Sot në date 12 Korrik 2024, unë Noterë Albana Xh. SPAHIU, anëtare e Dhomës Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Tiranë, me adresë Rr. H. H. Dalli, Nd. 59, Njësia Tregtare 11, pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, mora në shqyrtim dokumentacionin e paraqitur nga:

KËRKUESJA:

Znj. LAIDA SULOTI, atësia Llaqi, amësia Zenepe, shtetase Shqiptare, lindur më 23/08/1973, në Roskovec, banuese në adresë Haxhi Dede Reshat Bardhi; Nd. 31; H. 1; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, gjendja civile "e ve", madhore, me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 038635358 dhe nr. personal H35823044M.

E cila ka kërkuar:

OBJEKTI I KËRKESËS:

Lëshimin e Dëshmisë së Trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësin LLAMBRO SULOTI, i biri i Spiro dhe Janulla, i datëlindjes 06/02/1965, lindur në Fier, banues në adresë Haxhi Dede Reshat Bardhi; Nd. 31; H. 1; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023, shtetas shqiptar, madhor, mashkull, me gjendje civile "i martuar", nr. personal "G10602054K", i cili ka ndërruar jetë në datë 20/12/2023.

BAZA LIGJORE:

Nenet 316, 317, 318, 348, 360, 361 e vijues i ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë", me ndryshimet, neni 61, pika 1, shkronja d, j; Neni 62/d, nenet 97, 111, 112, 113 e vijues të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë".

Mbështetur në Kërkesën, dokumentacionin e paraqitur, të dhënat e kërkuara nga ligji dhe dispozitat ligjore në fuqi, unë Noterja.

KONSTATOJ SE:

Kërkesja Laida Suloti, ka depozituar në datë 12/04/2024, në këtë Zyrë Noterie kërkesën me objekt "Lëshimin e Dëshmisë së Trashëgimisë Ligjore" për të ndjerin **LLAMBRO SULOTI**, dhe përcaktimin e trashëgimtarëve ligjorë të tij.

Kërkesja Laida Suloti deklaroi se është bashkëshortja e të ndjerit **LLAMBRO SULOTI**, prandaj në cilësinë e trashëgimtarit të radhës së parë, në bazë të nenit 361 të Kodit Civil (i ndryshuar), ajo ka interes të ligjshëm në kërkesën për Lëshimin e Dëshmisë së Trashëgimisë Ligjore, pra legjitimohet të paraqesë kërkimin para kësaj zyre noteriale.

Kërkesja me qëllim vijimin e procedurave për lëshimin e Dëshmisë së Trashëgimisë, ka paraqitur dokumentacionin:





A2024051000092762368

- Çertifikatë Vdekje, LLAMBRO SULOTI, datë lëshimi 09.07.2024, Nj.Administrative Nr. 7, Tiranë, sipas të cilës rezulton se trashëgimlënësi ka vdekur në datë 02/07/2024.
 - Çertifikatë Martese (nga Akti), datë 30/04/2024 (në bazë të Librit/Akteve të Martesës, Akt Martese nr.210 datë 24/11/1990, ZGJC Arkiva Bashkia FIER.
 - Çertifikatë Familjare, datë 10.07.2024 (në bazë të regjistrit themeltar te Gjendjes Civile te vitit 2010), lëshuar nga ZGjC 379, Njesia Administrative nr. 7, Tiranë, Gjendja familjare e dates 01.01.2010.
 - Çertifikatë Familjare, datë 10.07.2024 (në bazë të regjistrit themeltar te Gjendjes Civile te vitit 2010), lëshuar nga ZGjC 379, Njesia Administrative nr. 7, Tiranë, Gjendja familjare e dates 31.12.2010.
 - Çertifikatë Familjare, datë 10.07.2024 (në bazë të regjistrit themeltar te Gjendjes Civile te vitit 2010), lëshuar nga ZGjC 379, Njesia Administrative nr. 7, Gjendja familjare e dates 01.01.2010, Tiranë, përbërja familjare datë 01.07.2024.
 - Çertifikatë Personale Znj. Laida Suloti, datë 11/07/2024, (në bazë të Regjistrit Kombëtar të Gj.C. të vitit 2010), Z.Gj.C. Nj. Adm. nr.7, Tiranë.
 - Çertifikatë Personale Znj. Joana Suloti, datë 11/07/2024, (në bazë të Regjistrit Kombëtar të Gj.C. të vitit 2010), Z.Gj.C. Nj. Adm. nr.7, Tiranë.
- Çertifikatë Personale Z. Spiro Suloti, datë 11/07/2024, (në bazë të Regjistrit Kombëtar të Gj.C. të vitit 2010), Z.Gj.C. Nj. Adm. nr.7, Tiranë

Referuar deklarimeve të kërkueses dhe dokumentacionit të sipërcituar, rezulton se:

Trashëgimlënësi **LLAMBRO SULOTI** ka vdekur në datë 02/07/2024. I ndjeri rezulton me gjendje civile "i martuar". Trashëgimlënësi rezulton të ketë qenë nën regjimin pasuror martesor të bashkësisë ligjore pasi nuk rezulton të ketë dokumentacion që të vërtetojë të kundërtën. I ndjeri ka qenë i martuar me shtetasen Laida Suloti (Goga), e bija e Llaqi dhe Zenepe, e datëlindjes 23/08/1973. Nga kjo martesë ata kanë lindur fëmijët e tyre, përkatësisht:


- 1. Joana Suloti**, e bija e Llambro dhe Laida, e datëlindjes 03/06/1992, lindur në Athinë, Greqi, Femër, aktualisht e gjallë.
- 2. Spiro Suloti**, e biri i Llambro dhe Laida, i datëlindjes 11/03/1994, lindur në Athinë, Greqi, Mashkull, aktualisht i gjallë.

Pasi administrova në tërësi provat shpresore të prezantuara nga Kërkuësja dhe dëgjova pretendimet e saj, Unë Noterja kryesisht, bazuar në nenin 111, 113 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", përpara shqyrtimit të bazueshmërisë në ligj e në prova të kërkesës, verifikova dhe konstatova se kjo çështje hyn në kompetencën e Shërbimit Noterial, të Degës Vendore Tiranë, përkatësisht Notere ALBANA XH. SPAHIU, me zyrë Noterie në Tiranë, NR.9, HAXHI HYSEN DALLIU, NR.59, NR.11, territor mbi të cilën shtrin kompetencën kjo zyrë për shqyrtimin e kësaj kërkesë. Në këto kushte:

Në bazë të deklarimeve të kërkueses, si dhe dokumentacionit të paraqitur prej saj, rezulton se Trashëgimlënësi **LLAMBRO SULOTI**, nuk ka pasur fëmijë të birësuar apo të lindur jashtë martese, nuk ka trashëgimtarë të tjerë përveç atyre të pasqyruar në trungun familjar, nuk rezulton që trashëgimtarët të kenë hequr dorë nga trashëgimi, të jenë bërë apo shpallur me vendim gjykate të padenjë për të trashëguar, apo të jenë përjashtuar nga trashëgimia. Nuk kemi të bëjmë me legun dhe as me barrën.

Bazuar në sa më sipër dhe në përputhje me dispozitat ligjore, unë Noterja vlerësoj se:

Së pari: Në bazë të nenit 348 të Kodit Civil (*i ndryshuar*), dhe ligjit 115/2014 "Për Ndarjen Administrativo-Territoriale të Njësitve të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë", unë Noterja, konstatoj se kjo çështje hyn në kompetencën e Shërbimit Noterial, të Degës Vendore Tiranë,





A2024051000092762168

përkatësisht Notere ALBANA XH. SPAHIU, me zyrë Noterie HAXHI HYSEN DALLIU, ND. NR.59, Njesia NR.11, në Nj. Bashkiake Nr.9, ne Bashkine TIRANE, territor mbi të cilën shtrin kompetencën kjo zyrë për shqyrtimin e kësaj kërkesë, pra kam kompetencën vendore për shqyrtimin e kërkesës së paraqitur.

Së dyti: Administrimi i Çertifikatës së Vdekjes, të datës 10/07/2024, Tiranë, vërteton faktin (bazuar ne legjislacion) se koha e çeljes së trashëgimisë është data **02/07/2024**, dita kur ka vdekur Trashëgimlënësi dhe referuar rregullimit ligjor në kohën e vdekjes së Trashëgimlënësit, ligji që duhet të zbatohet për lëshimin e Dëshmisë së Trashëgimisë është Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë (i ndryshuar), aktualisht në fuqi.

Në bazë të nenit 317 të Kodit Civil të sipërpërmendur "...trashëgimia me ligj zbatohet kur Trashëgimlënësi nuk ka bërë testament"

Mbi bazën e kërkesës me shkrim të kërkueses, për lëshimin e Dëshmisë së Trashëgimisë Ligjore për Trashëgimlënësin **LLAMBRO SULOTI**, unë Noterja i kam kërkuar Dhomës Kombëtare të Noterëve miratimin e Kërkesës për Lëshimin e Dëshmisë së Trashëgimisë Ligjore për **LLAMBRO SULOTI**. Dhoma Kombëtare e Noterëve është përgjigjur elektronikisht se

"Nga verifikimi në regjistrin Kombëtar të Testamenteve, nuk rezulton që Trashëgimlënësi, I/E ndjeri/a **LLAMBRO SULOTI** të ketë disponuar me testament gjatë gjallërisë së tij/saj"

Për sa më sipër, **DHKN Ju konfirmon se mund** të vijoni me lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë për trashëgimlënësin të ndjerin EMRI: Llambro; MBIEMRI: Suloti; ATËSIA: Spiro; AMËSIA: Janulla; VENDLINDJA:Fier; ATËLINDJA: 06/02/1965; VENDBANIMI I FUNDIT: Tirane; NR. PERSONAL: G50206057A".

Po ashtu, referuar deklarimeve të kërkuetit dhe aprovimit të Dhomës Kombëtare rezulton se për Trashëgimlënësin nuk është lëshuar më parë Dëshmi e Trashëgimisë Ligjore.

Në këtë rast për të lëshuar Dëshminë e Trashëgimisë Ligjore, do të zbatohen dispozitat ligjore të Kodit Civil (i ndryshuar), aktualisht në fuqi, që rregullojnë trashëgiminë ligjore. Kushtet që duhet të konkurrojnë në mënyrë që një person të thirret në trashëgim dhe të përfitojë nga pasuria trashëgimore janë:

- Personi duhet të ketë zotësi për të trashëguar;
- Personi duhet të bëjë pjesë në radhën e trashëgimtarëve ligjorë të cilëve në bazë të ligjit u takon pasuria trashëgimore.

Përsa i përket kushtit të parë, zotësi për të trashëguar në bazë të nenit 320 të Kodit Civil (i ndryshuar) ka "*...personi që në kohën e çeljes së trashëgimisë është gjallë...*"

Përsa i përket kushtit të dytë, neni 360 i Kodit Civil (i ndryshuar) thotë se "*Trashëgimtarët ligjorë janë fëmijët, fëmijët e fëmijëve, bashkëshortja, ...*", ndërsa Neni 361 paragraf 1, i Kodit Civil (i ndryshuar) thotë se "*Në rradhë të parë thirren në trashëgim fëmijët dhe bashkëshorti i aftë ose i paaftë për punë, duke trashëguar secili në pjesë të barabarta.*"

Neni 370 i Kodit Civil (i ndryshuar) thotë se "*Kur një nga bashkëtrashëgimtarët që thirret në trashëgim ka vdekur para trashëgimlënësit, ose është bërë i padenjë, ose ka hequr dorë nga trashëgimi, ose është përjashtuar nga trashëgimi dhe nuk ka persona që trashëgojnë me zëvendësim, pjesa që i takon atij u shtohet pjesëve të bashkëtrashëgimtarëve të asaj radhe*".

Nga interpretimi i dispozitave të mësipërme del se kur çelet trashëgimia ligjore, në rradhë të parë përfitojnë bashkëshorti dhe fëmijët e Trashëgimlënëseas, në pjesë të barabarta, kur janë gjallë në çastin e çeljes së Trashëgimisë.





A2024051000092762368

Për sa më sipër në rastin tonë trashëgimtarët ligjore të Trashëgimlënësit **LLAMBRO SULOTI**, janë:

1. **Laida Suloti**, e bija e Llaqi dhe Zenepe, shtetase Shqiptare (*bashkëshortja*), me nr. personal **H35823044M**.
2. **Joana Suloti**, e bija e Llambro dhe Laida, shtetase Shqiptare (*e bija*), me nr. Personal **J25503050R**.
3. **Spiro Suloti**, i biri i Llambro dhe Laida, shtetase Shqiptare (*e bija*), me nr. Personal **J40311060E**.

Të cilat trashëgojnë si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë të gjithë pasurinë trashëgimore të trashëgimlënësit, **me nga 1/3 (një e treta) pjesë të barabarta secili, të luajtshme e të paluajtshme** kudo që ndodhet dhe *po në këtë masë përgjigjen për detyrimet që rëndojnë mbi pasurinë trashëgimore*.

Përfundimisht nisur nga gjithë sa parashtrova më sipër, çmoj se kërkesa e paraqitur nga Kërkuësja Laida Suloti për lëshimin e Dëshmisë së Trashëgimisë Ligjore të të ndjerit **LLAMBRO SULOTI** është e bazuar në ligj dhe e dokumentuar, prandaj pranohet nga unë Noterja.

Kërkuësja deklaron se ka dhënë pëlqimin, në kuptim të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", pra për trajtimin e tyre nga unë noterja, si dhe për gjenerimin on-line nga portali SQDNE dhe e-albania të dokumentacionit certifikata.

PËR KËTO ARSYE

Unë Notere Albana Xh. SPAHIU, **bazuar në nenet: 316, 317, 318, 320, 348, 360 e vijues të Kodit Civil**, dhe neni 61, pika 1, shkronja d, j; nenet 97, 111, 112, 113 e vijues të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "**Për noterinë**", dokumentacionit të arkivuar pranë zyrës sime noteriale dhe verifikimit në Regjistrin Kombëtar të Testamenteve, e Regjistrin Kombëtar të Dëshmimeve të Trashëgimisë.

VENDOSA:

1. Pranimin e kërkesës së bërë nga Kërkuësja Laida Suloti.
2. Lëshimin e Dëshmisë së Trashëgimisë Ligjore për Trashëgimlënësin **LLAMBRO SULOTI**, duke përcaktuar si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë si vijon:

- | | |
|-----------------|------------------------------|
| 1. LAIDA SULOTI | bashkëshortja, me 1/3 pjesë; |
| 2. JOANA SULOTI | vajza, me 1/3 pjesë; |
| 3. SPIRO SULOTI | djali, me 1/3 pjesë; |

Për të gjitha pasuritë e Luajtshme e të paluajtshme kudo që të ndodhen dhe po në këtë masë përgjigjen për detyrimet që rëndojnë mbi pasurinë trashëgimore.

3. Shpenzimet noteriale për aktin e mësipërm janë në ngarkim të kërkuësës.
4. Sipas nenit 138 të Ligjit nr.110/2018 "Për Noterinë", kundër këtij vendimi (akti) mund të bëhet ankim në Gjykatën e juridiksionit përkatës, Tiranë.
5. **Ky vendim** në bazë të nenit 112 pika 3, te ligjit 110/2018, kur ka të bëjë me njohjen dhe kalimin me trashëgimi të një pasurie të paluajtshme dhe të të drejtave reale mbi të në favor të trashëgimtarëve ligjorë, **duhet të dërgohet për regjistrim brenda 30 ditëve nga nga e nesërmja e këtij vendimi në Agjensia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) të juridiksionit përkatës**, në rast se pasuria trashëgimore e Trashëgimlënësit ka qenë e regjistruar në ASHK (ZVRPP). Në rast të kundërt, për çdo ditë vonesë, aplikohen penalitët përkatëse sipas dispozitave ligjore në fuqi, referuar nenit 25, pika 2 e ligjit 111/2018 "Për Kadastrën".



A.2.024051000092162368

6. Dëshmia e trashëgimisë, pavarësisht rrethit të trashëgimtarëve në çastin e regjistrimit pranë institucionit përgjegjës për regjistrimin e pasurive të paluajtshme (ASHK), nuk mund të çënojë pjesën e bashkëshortit të prezumuar bashkëpronar për pasuritë e përfituara përgjatë martesës. Nëse trashëgimlënësi ka pasuri bashkëshortore të përfituara përgjatë martesës, por të regjistruara vetëm në emrin e tij, në institucionin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, apo ne QKB dhe QKL apo ne cdo institucion tjetër regjistrimi te te drejtave pasurore apo reale, regjistrimi i pjesës takuese të trashëgimisë ligjore do të bëhet duke zbritur 1/2 pjesë të prezumuar të bashkëshortit pasjetues, në referim me nenin 76 të Kodit Civil, nenit 112, pika 2, e ligjit 110/2018 “Për Noterinë”.

Gjithashtu nëse trashëgimlënësi është i prezumuar bashkëpronar në ndonjë nga pasuritë e regjistruara në institucionin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme ASHK, QKB (per aksione apo kuota) dhe QKL (per Licensat active) apo ne cdo institucion tjetër regjistrimi te te drejtave pasurore apo reale, atëherë, pjesa e prezumuar e bashkëpronësisë së tij do të kalojë tek trashëgimtarët ligjorë sipas pjesëve takuese.

Bashkëlidhur kopjese së ASHK, certifikata e martesës.

6. Bazuar në nenin 113 pika 8 të Ligjit nr.110/2018, vendimi origjinal mbetet në arkivin e zyrës së noterisë dhe lëshohen kopje të tjera, një për secilin trashëgimtar, dhe nga një kopje për ASHK per cdo pasuri që disponon.

7. Në bazë të nenit 113 të Ligjit nr.110/2018 “Për Noterinë”, ky vendim regjistrohet menjëherë në Regjistrin Kombëtar të Dëshmimeve të Trashëgimive pranë Dhomës Kombëtare të Noterisë.

8. Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë Noteri/ja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj dëshmie, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

9. Kundër këtij vendimi për lëshim dëshmi trashëgimie ligjore, mund të bëhet ankim në Gjykatën kompetente, sipas rregullave për gjykimin e mosmarrëveshjeve civile/administrative.

Taksa e pullës 200 Lek mbahet në kopjen e arkivës noteriale.

U lëshua në Tiranë sot, në datë 12 Korrik 2024.

NOTERE

ALBANA XH. SPAHIU



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Bashkia e Tiranës

Njësia administrative Nr. 7

Zyra e Gjendjes Civile 379



Data: 10.07.2024

CERTIFIKATË FAMILJARE

Në bazë të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010, vërtetohen të dhënat e mëposhtme:

Nr.	Emri e Mbiemri	Emri i Babait	Emri i Nënës	Gjinia	Lidhja me K. Familjarin	Data lindja	Gjendja Civile	Vendlindja	Shtetësia	Numri Personal
1.	Llambro SULOI	Spiro	Jamulla	M	Konjuntuar	06-02-1965	I/e martuar	Fier	Shqiptare	G50206057A
2.	Laida SULOI	Llaj	Zenepe	F	Bashkëshorte	23-08-1973	I/e martuar	Roskovec, Fier	Shqiptare	H35823044M
3.	Joana SULOI	Llambro	Laida	F	E Bija	03-05-1992	Beqar/e	Athine, Greqi	Shqiptare	J25503050R
4.	Spiro SULOI	Llambro	Laida	M	I Biri	11-03-1994	Beqar/e	Athine Greqi	Shqiptare	J40311060E
5.	-----									
6.	-----									
7.	-----									
8.	-----									
9.	-----									
10.	-----									

Kjo certifikatë lëshohet për

Përbeja familjare, datë 01.01.2010

Vullnet elektronikisht nga Drejtoria e
Regjistrimit të Gjendjes Civile
Data: 2024/07/10 09:46:38 +0200
bb924e009433486abafcc97463a12



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

QARKU Fier , RRETHI Fier

Zyra e Gjendjes Civile (Arkiva)

FIER

Fier, më 30/4/2024

CERTIFIKATË

Martese (nga Akti)

Në bazë të Librit / Akteve të martesës: **AKTI NR. 210 FIER**

, te vitit 1990

vërtetohen të dhënat e mëposhtme:

Përbërësit e Gjendjes Civile	Të dhëna të bashkëshortit	Të dhëna të bashkëshortes
Emri	LLAMBRO	LAIDA
Mbiemri	SULOTI	GOGA
Numri personal	-----	-----
Emri i babait	SPIRO	LLAQI
Emri i nënës	JANULLA	ZENEPE
Datëlindja	06.02.1965	23.08.1973
Vendlindja	FIER	ROSKOVEC
Vendbanimi	L. APOLLONIA 36/96	ROSKOVEC 18/50
Gjinia	M	F
Gjendja Civile	Beqar/e	Beqar/e
Shtetësia	SHQIPTARE	SHQIPTARE
Data e lidhjes së martesës	Akti nr.210	Date: 24/11/1990
Vendi i lidhjes së martesës	Z.GJ.C FIER	
Mbiemri para/pas martese	SULOTI	SULOTI

Kjo certifikatë lëshohet për **DOKUMENT**

Nënpunësi i Gjendjes Civile

Ervis Nilo

(nënshkrimi, vula)



Kopje elektronike nga Departamenti i Regjistrimit të Gjendjes Civile
Data: 2024/04/30 11:00:37 +02:00
502811292454301150302871021

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vërtetohet në mënyrë elektronike nga Departamenti i Regjistrimit të Gjendjes Civile.
(C) Kjo procedurë ndihmon në një sistem elektronik Regjistrimit të Gjendjes Civile.